



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:027489  
Datë: 26.01.2024  
Numri i dokumentit: 05248333

A.nr.226/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditëses A. S. nga fshati M., komuna e Gj., kundër të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati shtetëror B. Z., për shkak të anulimit të vendimit me numër reference AZHB.07/4/992/2022 të datës 19.12.2022, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 15.01.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadija e paditëses A. S. nga fshati M., komuna e Gj., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi me numër reference AZHB.07/4/992/2022 i datës 19.12.2022 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me praninë e palës së paditur e në mungesë të palës paditëse të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësja me padinë e datës 31.01.2023, ka kërkuar nga Gjykata që të aprovohet si e bazuar padia e tij e ushtruar kundër vendimit të të paditurës. Konsideron se vendimi administrativ i marrë është në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë detyrimet e palëve në raport me

kontratën administrative, se në procedurë administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të kontestuar, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe mbi këtë bazë nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike. I propozon Gjykatës që padinë ta aprovoj si të bazuar dhe të anuloj vendimin e të paditurës.

E paditura, me përgjigjen në padi të datës 20.06.2023 e konteston në tërësi si të pabazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Shton se me datën 04.06.2020 është realizuar kontrolli Ex-post me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2017 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017 dhe nenit 2 të Kontratës së nënshkruar ndërmjet përfituesit AZHB-së dhe është konstatuar se “aktiviteti artizanal është aktiv por funksionon në emër të NTP “K..” me pronar K.. S..”. Pas pranimit të raportit ex post, Drejtoria e Autorizimit të Pagesave ka bërë vlerësimin dhe ka gjetur se përfituesja nuk i është përmbajtur kushteve të Kontratës së nënshkruar të përcaktuar konkretisht në nenin 7, pika 4, ku përcaktohet se: “Të drejtat dhe obligimet e Kontratës nuk mund të jepen nga Përfituesi palës së tretë pa ndonjë marrëveshje specifike nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ka për detyrë që të mbikëqyrë në vazhdimësi mirëmbajtjen e pranimit dhe kriterëve përzgjedhës”, paditësja nuk ka njoftuar ose kërkuar plotësim dhe ndryshim të Kontratës por kishte ndërruar pronarin e aktivitetit bujqësor, nga emri i saj në emër të NTP “K..”, madje kishte ndërruar edhe lokacionin e Projektit. Me datën 01.06.2022, e paditura ka paraqitur kërkesë për përmbushje të obligimeve kontraktuale për paditësen. Paditësja është përgjigjur në këtë kërkesë por nuk i ka eliminuar të metat në raport të ex-post kontrollës. I propozon Gjykatës që padinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i të paditurit deklaroi: *“Mbesim pranë përgjigjes në padi dt.20.06.2023, e kundërshtojmë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses. Konsiderojmë se vendimi i të paditurës është vendim i drejtë dhe i bazuar në legjislacionin në fuqi. Pas leximit dhe administrimit të provave i propozojmë gjykatës që padia dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pa bazuar”.*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“E kundërshtojë edhe me tej padinë dhe kërkesëpadinë paditëses, konsiderojmë se duke u bazuara në raportin ekspos të kontrollës dt.04.06.2020, është konstatuar se i gjithë projekti nuk operon në emër të përfitueses në fjalë por në një emër tjetër, është bërë po ashtu ndërrimi i lokacionit dhe e thith kjo është në kundërshtim me udhëzimin administrativ 02/2017. Për kundër kërkesës së AZHB-së, për eliminimin e këtyre të gjeturave paditësja në këtë rast nuk i ka eliminuar të njëjtat dhe si rezultat i kësaj pala e paditur ka nxjerr vendim me numër 992/2022 dt.19.12.2022, për përjashtim për 3 vite nga programi përkatës. Lidhur me këtë çështje njoftojmë gjykatën se ne si palë e paditur kemi dorëzuar padi në Gjykatën Themelore në Gjilan për kthimin e mjeteve financiare të përfituara pa bazë, konkretisht në kundërshtim me ligjin me numër 03/L098 PËR Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Udhëzimin Administrativ 02/2017, andaj gjykatës i propozojmë që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoi si të pa bazuar në ligj”.*

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi me numër reference 07/4/992/2022 dt.19.12.2022, formulari për aplikim i dt.15.03.2017, certifikata e lindjes dt.21.02.2017, vërtetimi nga NLB dt.27.02.2017, plani i biznesit dt.14.03.2017, diploma e noterizuar me numër LRP.nr.1251/2017 dt.01.03.2017,

vërtetimi nga Komuna e Gjilanit me numër 3790 i dt.01.03.2017, certifikata e dt.15.03.2017, lista e vlerësimit të aplikimeve për vitin 2017, e dt.19.07. ndërsa viti nuk shihet, kontrata me numër 252/2017 e dt.14.08.2017, përgjigje e dt.25.11.2022, letër informimi me numër 4986 i dt.11.08.2017, njoftimi i dt.15.11.2017, raporti nga kontrolli në teren i dt.04.06.2020, shiqohen 38 foto të biznesit, raporti i Inspektorit dt.11.08.2017, lista për kontrollin e dytë pa datë , kërkesa për përmbushjen e obligimeve ligjore e dt.04.05.2022, shkresa me titull padi për kthim të mjeteve financiare e dt.21.12.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi si dhe propozimin e paditëses për anulimin e Vendimit në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi i kundërshtuar me padi është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se pretendimet se ekziston vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, nuk qëndrojnë.

Gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar drejtë të gjitha dispozitat ligjore me rastin e marrjes së vendimit të goditur me padi.

Gjykata konstatoi se procedura administrative e zhvilluar tek organi i paditur është kryer në përputhje të plotë me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton: *“Neni 132-Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi epror*

*1. Në rastin e paraparë nga paragrafi 5 i nenit 131 të këtij Ligji, organi epror do të shqyrtojë ankesën dhe, nëse është e nevojshme, do të zhvillojë shqyrtime shtesë, apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime të tilla dhe të njoftojë për to. Paragrafi 2 dhe 3 i nenit 131 të këtij Ligji zbatohen edhe në këtë rast.*

*2. Organi epror, me akt administrativ, do të refuzojë ankesën nëse ankesa është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë.*

*3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar.*

*4. Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.*

*5. Nëse është e nevojshme, organi epror mund të urdhërojë organin kompetent që të formulojë aktin që do të nxirret nga organi epror, bazuar në udhëzimet e këtij të fundit.*

*6. Ankesa nuk do të përkeqësoj situatën juridike në dëm të palës që ka paraqitur ankesë, përpos nëse shprehimisht është paraparë ndryshe me ligj”.*

Gjykata konstatoi se vendimi i të paditurës është në përputhje me nenin 47 të LPPA-së, në të cilin përcaktohet: *“Neni 47-Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar*

*1. Akti administrativ i shkruar përmban:*

1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjesë

1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit.

1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin)

1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrative apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.

Gjykata poashtu gjeti se pjesa arsyetuese e vendimit poashtu është në përputhje të plotë me nenin 48 të LPPA-së i cili përcakton: “Neni 48- Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim

1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.

Gjykata vërtetoi konstatimet mbi bazën e së cilave, e paditura ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe në plotëni me të drejtën materiale. Në lidhje me këtë gjykata ju referua Nenit 43 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet: “Neni 43

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ, në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative”. Në ndërlidhje me këtë, gjykata konstatoi se gjendja faktike nga organi i paditur është vërtetuar në mënyrë të drejtë ashtu siç e njëjta është paraqitur në mënyrë të drejtë edhe përmes Raportit ex-post të kontrollës të datës 04.06.2020 ku mbi bazën e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2017 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017 dhe nenit 2 të Kontratës së nënshkruar ndërmjet përfituesit AZHB-së, e paditura me të drejtë kishte vërtetuar gjendjen faktike duke konstatuar se aktiviteti artizanal është aktiv por funksionon në emër të NTP “Kujta-tex” me pronar Kujtim Sahiti, Rr. Gjinollëve, komuna Gjilan”.

Për më tepër, gjykata erdhi në përfundim se organi i paditur, duke u nisur nga vërtetimi i tillë i gjendjes faktike, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka zbatuar edhe të drejtën materiale, duke konstatuar se paditësja nuk i ishte përmbajtur kushteve të Kontratës së nënshkruar të përcaktuar konkretisht në nenin 7, pika 4, ku përcaktohet se: “Të drejtat dhe obligimet e Kontratës nuk mund të jepen nga Përfituesi palës së tretë pa ndonjë marrëveshje specifike nga Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ka për detyrë që të mbikëqyrë në vazhdimësi mirëmbajtjen e pranimit dhe kriterëve përzgjedhës”. Gjykata poashtu gjeti se nga shkresat e lëndës, nuk evidentohet që paditësja për këto ndryshime të ketë njoftuar të paditurën dhe as të ketë kërkuar ndryshim apo modifikim të kontratës ekzistuese me të paditurën sa i përket ndërrimit të pronarit të aktivitetit bujqësor por edhe sa i përket ndërrimit të lokacionit.

Gjykata refuzoi pretendimet e paditëses se në procedurë administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të kontestuar, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe mbi këtë bazë nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, për faktin që këto pretendime nuk u vërtetuan dhe as nuk u argumentuan as me padi dhe as në shqyrtim gjyqësor.

Duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike e juridike.

Gjykata analizoi dhe shqyrtoi edhe pretendimet tjera të paditëses, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj Gjykata vlerësoi se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thënie të paditëses në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr.226/2023, datë: 15.01.2024

G j y q t a r i

---

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.